



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

*Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al*

Nr. 194/\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 30.06.2020

**V E N D I M**

nr 77 date 30.06.2020

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË MALIQ “MBI  
AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”  
(Për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 30.12.2019)**

Në auditimin e ushtruar në Institucionin e Bashkisë Maliq me objekt “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2019, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale, efektet e të cilave shërbejnë si bazë për dhënien e një opinionit të pakualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Institucionin e Bashkisë Maliq sipas programit të auditimit nr. 194/1 prot, datë 18.02.2020, për periudhën nga data 01.01.2018 deri me datën 31.12.2019.

**II.** Të miratoj Opinionin e Auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

**A. OPINIONI I AUDITIMIT**

## **Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare.**

### **Për drejtimin e Bashkisë Maliq.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Maliq për vitin ushtrimor nga 01.01.2019-31.12.2019, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, pasqyrën e fonde neto/aktive neto, shënimet shpjeguese, si dhe Pasqyrat statistikore. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

### **Opinion i modifikuar me rezervë<sup>1</sup>:**

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin me rezervë”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë Maliq më 31 Dhjetor 2019, referuar Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” mbi të cilat, subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportimin e tyre.

### **Baza për opinion e modifikuar me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA<sup>1</sup>). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Maliq, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705), të cilat sipas mendimit tonë kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Maliq. Për këto arsye kemi dhënë opinion të me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

### **Përshkrimi i çështjeve:**

- a. Nga auditimi ka rezultuar se, nga 444 objekte inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën 1,112,185,445 lekë të pasqyruara në kontabilitet, për 19 objekte është pajisur me titull pronësie, për 21 objekte është në proces regjistrimi dhe për 404 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2.
- b. Nga auditimit ka rezultuar se, vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Maliq nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi, referuar SKK (5) “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të

<sup>1</sup> **Opinion i modifikuar, me rezervë (ISA 705-ISSAI 1705).** Audituesi duhet të shprehë një opinion me rezervë: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtëpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 31 objekte (ndërtesa, qendra shëndetësore, shkolla, etj) variojnë nga 1,000 lekë deri në 99,000 lekë.

- c. Nga auditimi ka rezultuar se, nga 4113 prona në total, një pjesë e konsiderueshme e tyre prej 3692 pronash, sipas përshkrimit të mëposhtëm, nuk janë regjistruar në aktivet afagjata materiale në kontabilitet dhe pasqyrat financiare, pasi sipas inventarëve të trashëguar nga Njësitë të Shkrira (NJSJH), janë paraqitur vetëm në sasi pa vlerën në lekë.

Mosveprimet në lidhje me konstatimet në germën b dhe c, mbi vlerësimin dhe rivlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Maliq:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Maliq, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

#### **Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë.**

##### **Për drejtimin e Bashkisë Maliq:**

Ne kemi audituar përputhshmërinë <sup>(2/3)</sup> e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të ligjeve rregullave dhe rregulloreve, termave apo kushteve të vendosura, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), në fushën e prokurimeve publike.

Auditimi ka përfshirë auditimin në 12 procedura prokurimi të zhvilluara në periudhën objekt auditimi 2018 dhe 8 procedura prokurimi të zhvilluar në periudhë 2019, bazuar në analizë rrisht <sup>(4)</sup>. vecanërisht ato dosje ku ofertë e kualifikuar e shpallur fituese janë ofertat e radhitura (*nga e dyta deri te e shtata, apo ofertë e vetme në konkurim*) të evidentuara me listë testimi.

##### **Opinion i pamodifikuar me “Theksim çështjeje”:**

<sup>2</sup> Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

<sup>3</sup> ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

<sup>4</sup> Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), Objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë rrisqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të procedurave të prokurimit, u konstatua se subjekti i audituar Bashkia Maliq ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit në kryerjen e procedurave të prokurimit publik, por njëkohësisht u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e pamodifikuar me theksim çështjeje”, që nën gjykimin profesional të audituesit nuk janë thelbësore, si dhe nuk kanë patur ndikim në realizimin e kontratave.

#### **Baza për opinion e pamodifikuar me “Theksim çështjeje”:**

Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>5</sup>, për të bazuar opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të disa çështjeve (jo materiale dhe të përhapura), për të cilat duam të tërheqim vëmendjen e subjektit, konkretisht:

U auditua përputhshmëria ligjore në zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për operatorët e shpallur fitues. Në opinionin tonë përse i përket shkallës së zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi për (*hartimin dhe miratimin e DST kriteret e kërkesave kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave*) në prokurimet publike nga Autoriteti Kontraktor (*bashkia Maliq*), referuar në kërkesat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, duke përjashtuar disa anomali materiale jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar për fushën e zhvillimit të procedurave. Besojmë se evidenca e auditimit që kemi marr janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë si më poshtë;

**a-**Në 21 procedura të audituara, në 2 (dy) rast është konstatuar shkelje në realizimin e procedurave të prokurimit publik, e cila ka sjellë shpallje fitues të ofertës së OE të radhës i mbetur në klasifikim me vlerë më të lartë se oferta e OE që nuk ka pranuar të lidhë kontratën, ndërkohë diferenca ndërmjet dy ofertave është disa hërë më e lartë se 2% e vlerës së fondit limit të prokuruar konkretishtë (*4deri17%*), në mospërputhje me pika 5, neni 58 “*Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimin e kontratës*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, me pasojë përdorimin e fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën totale 26.933.800 lekë pa tvsh.

**b-**Autoriteti Kontraktor në periudhat raportuese objekt auditimi (2018; 2019) me fondet publike ka nxjerr urdhëra prokurimi për shpenzime me objekt; “blerje mallra, shërbime dhe punë publike”, objekte të prokuruar me të njëjtën natyrë nëpërmjet procedurës “*Vlerë e vogël*” me copëzim të fondit publik, duke shmangur procedurat e tjera të prokurimit, ndërsa duhej të kishte prokuruar fondin për këto objekte të grupuara, ose me lote me qëllim përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondit publik, veprime në mospërputhje me gërma (ë) “*Prokurimi me vlerë të vogël*”, neni 32 “*Llojet e procedurave të prokurimit*”, me pika (8), neni 40 “*Procedura e prokurimit me vlerë e vogël*”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, si edhe Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 “*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*” i ndryshuar me Udhëzimi nr. 2, datë 24.04.2017, pika (1); pika (3) dhe ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015.

**c-**Komisioni Vlerësimit të Ofertave në procedurat e prokurimit të audituara sipas vlerësimit të tij për shpallje fitues të OE konkures është mbështetur në përzgjedhjen e procedurës së vlerësimit dhe kriterëve të kërkesave për kualifikim, ndërsa nga auditimi evidentohet se, fokusi i Autoritetit Kontraktor në vlerësimin e ofertave konkures është qëndrimi strikt në Dokumentat Standarte të Tenderit, në plotsimin e kriterëve të kërkesave për kualifikim,

<sup>5</sup> Objektivi i audituesve është të hartojnë dhe kryejnë ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojnë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).

sidomos edhe për ato kritere që mund të trajtohen lehtësisht si devijime të vogëla apo shumë të vogëla dhe që nuk çenojnë deformimin e vlerës së ofertës e parashikuar nga neni 53, pika 4 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ku qartësishtë citohet se: “Autoriteti Kontraktor e vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”.

**d-**Në lidhje me hartimin e miratimin e DST e kritereve të Kërkesave kualifikuese arrihet në konkluzionin se; Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit, në asnjë rastë nuk ka të argumentuar në lidhje me kritert e vendosura për kërkesat kualifikikese, ndërsa është mjaftuar vetëm me pasqyrimin e përshkrimin e termave të përgjithëshme se; “...vendosja e këtyre kërkesave është në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.1.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Kontrata për punë publike...”.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Maliq:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Maliq, janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të cilat duhet të mbështeten nga një sistem i kontrollit të brendshëm funksional. Stafii drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të prokurimeve publike dhe përdorimin e burimeve financiare të vëna në dispozicion në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:**

Objekivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>6</sup>, nëse procedurat e prokurimit publik, nuk paraqesin anomali materiale, si nga ana sasiore dhe cilësore, nëse veprimtaria e subjektit të audituar në fushën e prokurimeve publike, është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me ligjet dhe rregullat, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.Gjetje nga auditimi:** Në 4 (katër) proceduara prokurimi konkretishtë “Ndërtim KUZ në Njësitë Administrative”; “Blerje materiale për mirmbajtje rruge”; “Blerje vaj graso e antifrizë” e “Shërbimi periodik i eskavatorë” u konstaua se, në regjistrin e parashikimit i dërguar e publikuar në APP vlera e fondit limit pasqyrohet në shumën 29.386.461 lekë pa tvsh, ndërsa në urdhërat e prokurimit të publikuar nga AK vlera e fondit limit evidentohet në shumën 25.131.438 lekë pa tvsh me diferencë shuma 4.255.023 lekë, për ndryshimet (shitesa/paksime) nuk ka justifikim për diferencën ndërmjet vlerës në regjistri parashikimit me urdhër prokurimi, veprim në mospërputhje me VKM nr.914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu (I) “Përgjegjësia e Autoritetit kontraktor”, neni 4 “Regjistri parashikimeve të procedurave të prokurimit”, pika (3); (4). (Trajtuar më hollësisht në faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

<sup>6</sup> ISSAI 300 Parimet Bazë të Auditimit në lidhje me përputhshmërinë pohojnë se auditimi duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të paligjshme që mund të çenojnë ndjeshëm objektivat e auditimit

**1.1-Rekomandimi:** Titullari Autoritetit Kontraktor, njësia publike vendore (*bashkia Maliq*), Drejtoria e Financës e Njësia e Prokurimit, të analizojnë situatën për të nxjerrë përgjegjësitë me qëllim që të eliminohen diferencat nëpërmjet regjistrimit të parashikimit dhe urdhër prokurimit, duke pasqyruar saktë çdo ndryshim me rregjistrin (*shtesa/paksime*) konfirmuar nga dega e Thesarit.

*Menjëherë.*

**2.Gjetje nga auditimi:** Autoriteti Kontraktor, njësia publike vendore (*bashkia Maliq*) në përfundim të periudhave raportuese, në asnjë rast nuk ka përgatitur dhe hartuar asnjë raport të hollësishëm në lidhje me korrektësinë dhe cilësinë e realizimit të suksesshëm të kontratave të lidhura me OE, ndërsa në kontratat e përpiluara e miratuara, nuk ka emëruar e përcaktuar me nen përkatës, personin ose strukturën organizative përgjegjëse në emër të palëve kontraktuese për ndjekjen e realizimit të kushteve të kontratës, veprim në mospërputhje me Kreu (IX) “*Ekzekutimi e mbikqyrja e kontratës*”, neni 77 “*Mbikqyrja e kontratës*”, pikat (3); (4) parashikuar në kontratë me nen përkatës “*Përfaqësimi palëve*”. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 61-96 të Raportit të Auditimit*).

**2.1-Rekomandimi:** Titullari Autoritetit Kontraktor, njësia publike vendore (*bashkia Maliq*); Njësia e Prokurimit të analizojnë situatën me qëllim në të ardhmen, për korrektësinë e cilësinë dhe realizimin e suksesshëm të kushteve në kontratat e lidhura, të hartohet një raport i hollësishëm nga personi, ose struktura organizative e emëruar, të cilësuar si përgjegjëse në emër të Autoritetit Kontraktor.

*Menjëherë.*

**3.Gjetje nga auditimi:** Në 5(*pesë*) procedura prokurimi konkretishtë; “*Blerje mjet transporti për nevoja të Bashkisë*”; “*Blerje pajisje zyresh*”; “*Blerje mjet zjarrfikës(I)*”; “*Blerje mjet zjarrfikës(II)*” e “*Blerje materiale ndërtimi*”; Komisioni i ngritur me urdhër për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e argumentimin e vlerës së fondit limit, në procesverbalet e mbajtur në asnjë rast nuk ka evidentuar në lidhje me mënyrën e përlllogaritjes dhe të argumentimit të vlerës limit të kontratës (*fondi limit*), por është mjaftuar vetëm me pasqyrimin e përshkrimit se; “*...komisioni kryen llogaritjen e vlerës së fondit limit për blerje zyresh mbështetur në VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni (59) Llogaritja e vlerës së kontratës....*”, ndërsa në të gjitha rastet mungojnë burimet e informacionit dhe mënyra e përlllogaritjes e vlerës së fondit limit. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 61-96 të Raportit të Auditimit*).

**3.1-Rekomandimi:** Titullari Autoritetit Kontraktor, njësia publike vendore (*bashkia Maliq*), Njësia e prokurimit dhe Hartuesit e specifikimeve teknike e përlllogaritjes së vlerës limit të njoftimit të kontratës (*fondi limit*), në të gjitha procedurat e prokurimit të kenë si objekt kryesor faktin se, argumentimi i vlerës së fondit limit ti shërbejë nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe të jap argumente të hollësishme në lidhje me burimet e informacionit për referimet e cmimit mallit, punëve e shërbimeve publike që do prokurohen.

*Menjëherë.*

**4.Gjetje nga auditimi:** Në 4(*katër*) procedura prokurimi konkretishtë; “*Shërbime pastrimi dhe gjelbërimit*”; “*Ndërtim Ujësjellës Bregas, Strelcë*”; “*Rikonstruksion objekte shkollor Njësi Administrative faza (II)*”; “*Riparim vepra ujore, portobarazhe në fusha Maliq*”, Njësia e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit në procesverbalet e mbajtur në lidhje me hartimin dhe miratimin e kriterëve të kërkesave kualifikuese në DST, nuk ka argumentuar në asnjë rast për kriteret e vendosura në secilën kërkesë të veçantë të kualifikimit, ndërsa është mjaftuar vetëm me listimin e kërkesave për kualifikim me pasqyrimin e përshkrimi të termave në mënyrë të përgjithshme, apo janë vendosur kriteret kualifikuese të pa nevojshme e të ekzagjeruar, në mospërputhje me ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, neni 26 “*Kontratat për punë publike*”, pika (5), neni 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*” pika (1); neni 15 dhe 22 të ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 26; neni 61 “*Hartimi dhe publikimi dokumenteve të tenderit*”, pika

(2), paragrafi (2); neni 61 “Hartimi dhe publikimi dokumenteve të tenderit”, pika (1); (2), paragrafi (2). *(Trajtuar më hollësisht në faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).*

**4.1-Rekomandimi:** NJHDST në hartimin e miratimin e kriterëve të kërkesave kualifikuese në DST, të argumentojë me hollësi secilin kriter në kërkesat kualifikuese të pasqyruara në procesverbalin përkatës. Argumentimi të bëhet i hollësishëm mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave të manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjëseve, licencave, etj, me analizë të hollësishme për secilin kriter të vendosur.

*Menjëherë.*

**5.Gjetje nga auditimi:** Në 2(dy) procedura prokurimi konkretisht; “Blerje mjete zjarrfikëse (I)” dhe “Blerje mjete zjarrfikëse II”; KVO ka shpallur fituese edhe ofertën e OE e vetme në konkurim të cilat me devijime të vogëla nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese, ndërsa KVO këto procedura e prokurimit duhej ti kishte anuluar për mungesë konkurrence, pasi në garë nuk ngelet asnjë ofertë e vlefshme, në mospërputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika (1), neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” dhe VKM nr.914, datë 29.02.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu (VIII) “Kushte të përgjithshme për zbatim”, neni 73 “Mungesa e konkurrencës”. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).*

**5.1-Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor njësi publike vendore (*bashkia Maliq*), të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësit për kualifikimin dhe mos kualifikimin e OE konkurruese për devijime të vogla në plotësimin e kriterëve të kërkesave kualifikuese. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi kontraktori për shkak të mangësive nuk jep siguri për kryerjen me sukses e cilësi të kushteve të kontratës.

*Menjëherë.*

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtoria Financës, Bashkia Maliq deri më datë 30.04.2020, nuk ka likuiduar detyrime në vlerën gjithsej 19,500,545 lekë, për fatura dhe vendime gjykate të cilët i përkasin vitit 2019 e para (*për mallra e shërbime në vlerën 14,337,566 lekë dhe shpenzime për Vendime Gjykate në vlerën 2,970,749 lekë*), veprime në kundërshtim me nenin 52- Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 –Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore *(Trajtuar më hollësisht në faqen 20-29 të Raportit të Auditimit).*

**6.1-Rekomandimi:** Bashkia Maliq Drejtoria Financës, bazuar në; Udhëzimin plotësues i Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësive të qeverisjes vendore*”, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **19,500,545 lekë**.

*Menjëherë.*

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore të planifikuar gjithsej në vlerën 300,000 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë kryer shpenzime sipas realizimit faktik në vlerën 129,176 mijë lekë duke mos realizuar shpenzimet në vlerën 170,824 mijë lekë, për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore të planifikuar gjithsej në vlerën 300,000 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë kryer shpenzime sipas realizimit faktik 107,323 mijë lekë duke mos realizuar shpenzimet në vlerën 192,768 mijë lekë, veprime në

kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 20-29 të Raportit të Auditimit).*

**7.1-Rekomandimi:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Maliq të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

*Në vazhdimësi.*

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Maliq, për subjektet të cilat nga MIE kanë marrë leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore nuk janë zbatuar kërkesat ligjore si: -nuk kanë riklasifikuar fondin pyjor/kullosor, nuk kanë pezulluar veprimtarinë e këtyre subjekteve edhe pse me shkresat nr. 6096 dhe 6096/2, datë 26.12.2017 i kanë njoftuar për aplikim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit këto subjektet, për të paraqitur kërkesën për heqjen nga fondi pyjor, vazhdimin e procedurave për aktivitet shfrytëzimi karriere dhe lidhjen e kontratës për pyllzimin e sipërfaqes që kanë marrë për shfrytëzim. Veprimet e më sipërme, mos hapja e dosjeve të veçanta për këto subjekt dhe moszbatimi i procedurave për heqjen nga fondi pyjorë të sipërfaqeve të dhëna për shfrytëzim, nga subjektet për sipërfaqen 6.6 ha, pronë (aset) i Bashkisë Maliq, vijnë në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin Kullosor”, me pikat 3,7,9,10,11;12, VKM nr.1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 20-29 të Raportit të Auditimit).*

**8.1-Rekomandimi:** Drejtoria e Pyjeve e Kullotave Bashkia Maliq, të marrë masa për riklasifikimin e fondit pyjor/kullosor, të pezulloi veprimtarinë e subjekteve deri sa sipërfaqja pyjore që shfrytëzojnë të hiqet nga fondi pyjor dhe vazhdimin e procedurave për lidhjen e kontratës për pyllzimin e sipërfaqes që kanë marrë për shfrytëzim.

*Menjëherë.*

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga KLSH i janë rikërkuar Bashkisë Maliq 12 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, nga verifikimi rezulton se janë zbatuar plotësisht 6 masa si dhe janë në proces zbatimi 6 masa. Masa për shpërblim dëmi: KLSH i ka rikërkuar kryetarit të Bashkisë Maliq, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 1,968,603 lekë, nga verifikimi rezulton se për 3 masa me vlerë 1,968,603 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera, për vlerën prej 30,000 lekë edhe pse janë bërë njoftimet nuk është arkëtuar asnjë lekë, ndërsa për 2 rastet e tjera në vlerën 1,938,603 lekë ndaj 2 operatorëve ekonomikë është hapur proces gjyqësor. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 105-114 të Raportit të Auditimit).*



**9.1-Rekomandimi:** Bashkia Maliq të analizoj dhe të vazhdoj zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm dhe në vijim të merren masa të menjëhershme për zbatimin e tyre deri në përfundimin e proceseve gjyqësore për shpërblimin e dëmit.

*Menjëherë.*

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procedurën e ngritjs dhe funksionimit të NJAB u konstatua se, Njësia e Auditimit të brendshëm në bashki e cila ka funksionur me sturkturë në nivel sektori me 1 auditues i certifikuar, ndërsa njësia Auditimit të brendshëm kërkohet të jetë e organizur me 3 punonjës të certifikuar, veprim në mospërputhje me neni 10, ligji nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pika 3, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njesisve të Auditimit të Brendshëm në Sektorin publik”. (Trajtuar më hollësisht në faqen 18-20 të Raportit të Auditimit).

**10.1-Rekomandimi:** Bashkia Maliq të marr masa që njësia e auditimit të Brendshëm të organizohet dhe të funksionojë me 3 punonjës të certifikuar kërkesë e parashikuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.

*Menjëherë.*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, nga 444 objekte inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën 1,112,185,445 lekë, Bashkia Maliq për 19 objekte është pajisur me titull pronësie, për 21 objekte është në proces regjistrimi dhe për **404 objekte inventari**, si më poshtë:

-llog. 211 “Pyje plantacione”, 7 objekte në vlerën 12,793,567 lekë;

-llog. 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 201 objekte në vlerën 822,224,436 lekë;

-llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 236 objekte në vlerën 277,167,442 lekë.

**nuk posedon titull pronësie**, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2.

Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35. *Në mënyrë më të hollësishme trajtohet në Pikën 3.2, faqe 21-60 të Raportit të Auditimit.*

**11.1-Rekomandimi:** Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**Afati: 6-muaj**

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, **nuk paraqet “vlerën reale”** të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Maliq, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtëpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 31 objekte (ndërtesa qendra shëndetësore, shkolla, etj) variojnë nga 1,000 lekë deri në 99,000 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”. *Në mënyrë më të hollësishme trajtohet në Pikën 3.2, faqe 21-60 të Raportit të Auditimit.*

**12.1-Rekomandimi:** Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se nga 4113 prona në total, një pjesë e konsiderueshme e tyre prej 3692 pronash, sipas përshkrimit analitik në Tabelën anekse nr. 3.2.2/4, nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe Pasqyrën e Pozicionit Financiar “Aktivet afagjata material”, pasi sipas inventarëve të trashëguar nga Njësitë të Shkrira (NJSH), janë paraqitur vetëm në sasi pa vlerë. Situata e mësipërme, e cila daton prej bashkimit të Njësive të Shkrira, është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”. Në mënyrë më të hollësishme trajtohet në Pika 3.2, faqe 21-60 të Raportit të Auditimit.

**13.1-Rekomanimi:** Titullari i Bashkisë Maliq të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes, së pari nëpërmjet parashtrimit të të gjithë problematikës në Grupin e Menaxhimit Strategjik, bazuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kreu II, pika 16, si dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve, por pa vlerën respektive, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Bashkisë Maliq më 31.12.2020.

### **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË E EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Në 3(tre) procedura prokurimi u konstatua se; Komisioni i ngritur me urdhër për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës fondit limit, në procesverbalet e mbajtur nuk ka evidentuar në lidhje me mënyrën e përlllogaritjes e argumentimit të vlerës limit të njoftimit të kontratës (*fondi limit*), është mjaftuar vetëm me pasqyrimin e përshkrimit se; “...komisioni kryen llogaritjen e vlerë së fondit limit për blerje zyresh mbështetur në VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni (59) Llogaritja e vlerë së kontratës...”, ndërsa mungojnë të gjitha burimet e informacionit për mënyrën e përlllogaritjes të vlerës së fondit limit, duke sjell pasojë rritje të padrejtë të vlerës së prokuruar e cila konsiderohet përdorim i fondit publik *pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 2.517.196 lekë pa tvsh* të detajuara për secilën procedurë prokurimi sa më poshtë: (*Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit*).

**1.1.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt; “*Blerje Ndriçues rruge me krah LED*”, komisioni për hartimin e specifikimeve teknike e përlllogaritjen e fondi limit për blerje ndriçues rruge me krah LED ka pasqyruar se; “...komisioni bazuar në cmimet e marra nga operatorët që ofrojnë mallra të natyrës së objekt prokurimi në treg kryen llogaritjen e cmimit për objektin e ndriçues rrugor LED, mbështetur në VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni (59) Llogaritja e vlerë së kontratës, pika (2)....” i sygjeron titullarit fondin limit 1.666.607 lekë pa tvsh dhe 1.999.928 lekë me tvsh. Pikërishtë mbi bazën ligjore që komisioni është referuar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, vetëm ka pasqyruar e analizuar se, “...nga testimi i tregut u morën ofertat me cmimet e ofruara nga 3 (tre) shoqëri për 2 artikuj (ndriçues led), mbi të cilat ka përlllogaritje cmimi mesatarar dhe në përfundim ka evidentuar vlerën totale të fondit limit pa tvsh i prokuruar...”, bashkëlidhur “*ofertat e shitje*”. Nëpërmjet kësaj përlllogaritje e vlerë së fondit limit konstatohet se, komisioni ka llogaritje cmim mesatar pa tvsh, ndërsa referuar në procedurat tatimore, “*cmimi me faturë shitje malli*” i lëshuar nga subjekti, përfaqëson cmimin e mallit me të gjitha detyrimet përfshirë edhe TVSH. Në këto kushte përlllogaritja e vlerës së fondit limit ka sjell përfshirje 2 herë TVSH në vlerën e fondit limit. Për pasojë *shuma prej 333,321 lekë vlera e përlllogaritje TVSH, do konsiderohet përdorim i fondit publik pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet*, ka rritur padrejtësishtë vlerën e fondit limit, në mospërputhje me ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1 “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, gërmat (a); (b); VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu (II) “*Rregullat e Përgjithshme të prokurimit*”, neni 59 “*Llogaritja e vlerës së kontratës*”. Kreu (VII) “*Zyrtarët e*

prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2).

**1.2.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën prokurimit me objekt: “Shërbime të pastrimit e gjelbërimit” komisioni për argumentim e përlllogaritje të vlerës limit të njoftimit të kontratës (fondi limit) dhe miratimin e specifikimeve teknike, ka hartuar preventivin e shërbimi parstrimit e gjelbërimit me volume e kosto për njësi periudha 1 vit me vlerën 27.928.430 lekë pa tvsh, ndërsa me urdhër nr.463, datë 24.10.2016 ka përlllogaritur me analizë të hollësishme strukturën e kostos për njësi shërbimi pastrimi e grumbullimi të cilat u bënë pjesë e DST. Megjithatë në preventiv krahas zërave të kostos për shërbimi pastrimit e grumbullimit të mbetjeve urbane, janë preventivuar edhe zëra punimi që nuk i përkasin objektit të prokurimit konkretisht; zëri preventivit “Transport materiale ndërtimi dheu deri 3 km” me vlerën 51.000 lekë; zëri preventivit “Hedhje, rrafshim mbushje dheu me krah” me vlerën 58.600 lekë dhe zëri preventivit “Bojë komponente (sprajt)” me vlerë 859.275 lekë e përlllogaritur **në vlerë total 968.875 lekë pa tvsh**, duke rritur padrejtësishtë fondin limit, pasi këto zëra punimi në preventiv janë objekt IMTV<sup>së</sup>, apo Policisë bashkisë për penalizim të subjekteve që krijojnë materiale inerte. Dhënia e ofertave nga OE mbi këto zëra të preventivit, bën të pamundur vlerësimin e drejtë të ofertës nga KVO, pasi AK për ndërtimin e kostos me zëra punime të pa argumentuar, veprim në mopërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 17 “Oferta ekonomike”. (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Projektraportit të Auditimit).

**1.3-Rekomandimi:** Titullari Autoritetit Kontraktor, njësia publike vendore (bashkia Maliq), të analizojë dhe të nxjerr përgjegjësitë për situatën e mësipërme me qëllim që në të ardhmen të eliminohen rastet e përlllogaritjes padrejtësishtë të vlerës limit të njoftimit të kontratës (fondi limit), duke përfshirë 2 herë TVSH në vlerën e fondit limit, si edhe duke pasqyruar në preventiv zëra punimi të cilët janë objekt i veprimtarisë IMTV<sup>së</sup>, apo Policisë së bashkisë, kanë sjellë pasojë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin **pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondit publik në vlerë totale 1.302.196 lekë pa tvsh**.

**Menjëherë.**

**1.4.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim Ujësjellës Bregas, Strelcë” për argumentimin e përlllogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës (fondi limit) në preventivin e punimeve në vlerën 19.491.151 lekë Drejtoria e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të teritorit nga ing.Spiro Koti me analizë teknike janë ripërpunuar cmimet e zërave të punimeve ndërsa u konstatua se, hartuesi i preventivit ka miratuar edhe zëra punimeve të cilat nuk janë detyrim i investitorit, por detyrim për tu likujduar nga abonenti familjar, ndërsa mbi këto zëra kanë ofertuar OE në konkurim për zërat “FV Lidhje familjare matës uji komplet fi ¾” = 20mm+ tubo NR10”, sasia 270copë me vlerë 1.215.000 lekë. Nëpërmjet kësaj mënyre përlllogaritje, argumentimi dhe miratimi rezultoi se, AK ka rritur dhe ka sjellë konkurim të padrejtë të vlerës limit të njoftimit të kontratës (fondi limit), veprime në mospërputhje me VKM nr.1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizime SHA”, pika (2.7) “Ujëmatësat”, nënpika (3) ku qartësishtë citohet se; “...Ujëmatësi dhe saraqineskat e instaluar në objekte janë në pronësi të pronarit të objektit/apartamentit i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre.....”. Në këto kushte vlera **1.215.000 lekë pa tvsh, konsiderohet përdorim i fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet** (vlera e ujmatësit e instalimi), si pasojë e përlllogaritjes dhe prokurimit të padrejtë në vlerën e fondit limit. (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**1.5-Rekomandimi:** Titullari Autoritetit Kontraktor, njësia publike vendore (bashkia Maliq), të analizojë situatën e mësipërme, të nxjerr përgjegjësitë dhe të marr masa për të evidentuar nëpërmjet “Ujësjellës Kanalizime”sha të 270 abonentët familjar përfitues, ndërsa vlera e ujmatësit i përfituar nga secili abonent të pasqyrohet në faturën e konsumit të ujit, si detyrim i abonentit familjar, vlerë e cila ka dhënë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin **pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondit publik në vlerën 1.215.000 lekë pa tvsh**.

**Menjëherë.**

**2.Gjetje nga auditimi:** Në 2(dy) procedura prokurimi u konstatua se; KVO ka shpallur fituese ofertën e radhës e mbetur në klasifikim me vlerë më të lartë se, vlera e ofertës konkurrese e paraqitur nga OE i cili është tërhequr nga lidhja e kontratës, ndërkohë që diferencë ndërmjet dy ofertave është disa herë më e lartë se 2% e vlerës së fondit limit të prokuruar konkretisht; (4deri17%), ka sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik *pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerë totale 4.639.656 lekë pa tvsh* të detajuara për secilën procedurë sa më poshtë: (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**2.1.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje mjet transporti për nevojat e Bashkisë” e zhvilluar në datën 18.06.2018 me fond limit 1.250,000 lekë pa tvsh. Në këtë procedurë kanë marr pjesë 3 OE, nga të cilët 2 OE janë kualifikuar me kriteret e kërkesave kualifikuese të miratuara e pranuar nga OE në DST, ndërsa KVO ka shpall fitues ofertën konkurrese të OE “R”shpk me vlerë të ofertës 1.200.000 lekë pa tvsh, pasi OE “P”shpk nuk ka depozituar “*formular për sigurim kontratës*”, duke u tërhequr nga lidhja e kontratës. Në këto kushte KVO duhej të kishte anuluar procedurën e prokurimit sepse, oferta e shpallur fituese në renditje është me diferencë nga oferta e tërhequr në shumën 51.000 lekë pa tvsh, më e lartë se (2%) e vlerës fondit limit saktësisht (4%). Për pasojë përzgjedhja e ofertës së radhës dhe lidhja e kontratës me këtë shoqëri në *vlerën 1.200.000 lekë pa tvsh* do konsiderohet përdorim i fondit publik *pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet*, në mospërputhje me neni 58 “Njoftimi fituesit dhe nënshkrimi kontratës”, pika (5), të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**2.2.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje sistem fonie dixhitale + foni aparat” e zhvilluar në datën 12.03.2018 me fond limit 3.500,000 lekë pa tvsh. Në këtë procedurë kanë marr pjesë 8 OE, nga të cilët 2 OE janë kualifikuar me kriteret e kërkesave kualifikuese të miratuara e pranuar nga OE në DST, ndërsa KVO ka shpall fitues ofertën konkurrese të OE “A”shpk me vlerë të ofertës 3.439.656 lekë pa tvsh, pasi OE “A”shpk nuk ka depozituar “*formular për sigurim kontratës*”, duke u tërhequr nga lidhja e kontratës. Në këto kushte KVO duhej të kishte anuluar procedurën e prokurimit sepse, oferta e shpallur fituese në renditje është me diferencë nga oferta e tërhequr në shumën 601.362 lekë pa tvsh, më e lartë se (2%) e vlerës fondit limit saktësisht (17%). Për pasojë përzgjedhja e ofertës së radhës dhe lidhja e kontratës me këtë shoqëri do konsiderohet përdorimi fondit publik *pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerë 3.439.656 lekë pa tvsh*, në mospërputhje me neni 58 “Njoftimi fituesit dhe nënshkrimi kontratës”, pika (5), të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në pika 4 programi, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**2.3-Rekomandimi:** Titullari Autoritetit Kontraktor, njësia publike vendore (bashkia Maliq), të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e mësipërme me qëllim që në të ardhmen të eliminohen rastet e kualifikimit të ofertave të renditura pas ofertës së OE për të cilat nga KVO është pranuar deklarata “*dorëheqje nga oferta*”, ndërkohë që diferencat ndërmjet dy ofertave janë disa herë më të larta se (2%) e vlerës së fondit limit të prokuruar, ka sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik *pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën totale 4.639.656 lekë pa tvsh*, ndërsa KVO duhet të udhëhiqet nga zbatimi kritereve të parashikuara nga ligji për prokurimet publike me qëllim sigurimin me eficientë maksimale të fondit dhe dhënie përparësi ofertës me vlerë më të ulët, si kriteri bazë i parashikuar në kriteret e vendosura në DST.

**Menjëherë.**

**3.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje zyrash” u konstatua se, KVO nuk ka kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik, vlera e të cilës është më e ulët se oferta fituese, ndërkohë që gabimi nuk është aritmetikor si pasojë e shumëzimit të sasisë me cmimin për njësi, por është gabim i paraqitur në paraqitjen e vlerës totale të ofertës, ndonëse vlera e diferencës së paraqitjes gabim të ofertës është shuma (110.800 lekë, ose 2.4%), megjithëse më e madhe se 2% me 04%, diferencë kjo e pa përfillshme, megjithatë u konstatua

se edhe oferta e shpallur fituese për devijime shumë të vogla nuk i plotëson kriteret e kërkesave në kualifikim në DST, ka sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik *pa ekonomicitet, efincë dhe efektivitet në vlerën 872.600 lekë pa tvsh.* (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**3.1-Rekomandimi:** Titullari Autoritetit Kontraktor, njësia publike vendore (*bashkia Maliq*), të analizojë dhe të nxjerë përgjegjësi për kualifikimin e OE në procedurën e prokurimit dhe të konsiderojë faktin se, edhe OE i cili nuk plotëson kriteret e kërkesave për kualifikim në DST, ndërsa kualifikimi ka rrisht dhe nuk jep garanci për kryerjen me cilësi të kontratës, ka sjellë efekt negativ financiar me impakt *në përdorimin e fondit publik pa ekonomicitet, efincë dhe efektivitet në vlerë 872.600 lekë pa tvsh.*

**Menjëherë.**

**4.Gjetje nga auditimi:** Në *6 (gjashhtë)* procedura prokurimi u konstatua se; KVO me qëndrimin strikt në vlerësimin e ofertave konkurruese, nuk ka kualifikuar ofertat e paraqitura nga OE konkurrues, vlera e të cilave është më e ulët se vlera e ofertës e shpallur fituese, për devijime shumë të vogla nuk plotësojnë kriteret e kërkesave në kualifikim të vendosura e miratuara në DST, ka sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik *pa ekonomicitet, efincë dhe efektivitet në vlerë totale 17.806.465 lekë pa tvsh* të detajuara për secilën procedurë sa më poshtë: (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**4.1.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit*” e zhvilluar në datën 17.07.2018, me fond limit *139,642,150 lekë pa TVSH*, në konkurim kanë marrë pjesë 4 OE, ku për OE “*R*”shpk nga KPP<sup>së</sup> është marrë Vendimi nr.708/2018, datë 22.10.2018 nëpërmjet të cilit është lënë në fuqi vlerësimi KVO<sup>së</sup> dhe miratimi Titullarit të AK për mosplotësim të kriterëve në kërkesat kualifikuese në DST, ndërsa ofertat e OE “*S*”shpk dhe “*P*”shpk nuk plotësojnë disa kriteret në kërkesat kualifikuese në DST, ndërsa KVO ka kualifikuar e propozuar shpallje fitues ofertën e OE “*K*”SHPK e klasifikuar në radhitje (*e treta*) me vlerë *136.398.947 lekë pa tvsh* e cila nga auditimi rezulton se edhe kjo ofertë ka mangësi në kriteret kualifikuese të konsideruara devijime të vogla si: (*Punonjëse ing.Mjedisit për periudhë 6/muaj (nga 04.01.2017 deri 22.06.2017) nuk është certifikuar në fushën e mjedisit; Lejet Mjedisore të lëshuara nga QKL për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit lloji (Kodi III.1.A) janë të lëshuara kanë vendin kryejë të veprimtarisë në njësitë Bashkiake nr.9; nr.11 Bashkia Tiranë dhe bashkia Korçë; Mjeti fshesë në pjesën përpara krahu i djathtë të shasisë ka të montuar vetëm 1(një), ndërkohë në DST është kërkuar të disponojë të montuara (2fshesa anësore (majtas e dhjathtas) dhe 1 fshesë qëndrore); Mjetet e paraqitura në konkurim nuk plotësojnë kriterin kualifikues të cilësuar me kapacitet (nga 1.5 deri 2 ton), për këto mangësi KVO duhej të kishte anuluar procedurën e prokurimit me argumentin se, asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotëson kriteret kualifikuese të vendosura në DST, me pasojë *përdorimin e fondit publik pa ekonomicitet, efincë dhe efektivitet për vlerën 17.164.826 lekë pa tvsh,* (diferenca ndërmjet ofertës fituese dhe ofertës me vlerë më të ulët në konkurim). Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika (1), germa (ç); neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika (1); neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika (3), pika (5), gërmat (a) dhe (c); neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika (1), germa (a); VKM nr. 914, datë 29.02.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika (3); neni (67) “Klasifikimi i ofertave”; neni (68) “Raporti përmbledhës”, Kreu (VIII) “Kushte të përgjithshme për zbatim”; neni (73) “Mungesa e konkurrencës”, pika (1). (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).*

**4.2.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt:“*Ndërtim Ujësijellës Bregas, Strelcë*” e zhvilluar në datë 29.10.2018, me fond limit *24.997.393 lekë pa tvsh.* Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 19 OE, ndërsa KVO ka vlerësuar, klasifikuar, kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE “*A*”shpk e klasifikuar në radhitje (*e dyta*) me vlerë *14.640.410 lekë pa tvsh,* ndërsa është skualifikuar oferta konkurruese

BOE “A■” shpk e klasifikuar në radhitje (*e para*) me vlerë 14.406.930 leke pa tvsh më e ulët se oferta e shpallur fituese me diferencë shuma 35,480 lekë pa tvsh, ndërsa nga auditimi rezulton se; KVO në lidhje me mosvlerësimin e ofertës me vlerë më të ulët është gabuar në vlerësimin e dhënë, sepse kjo ofertë e pa vlerësuar me dokumentat e dorëzuara së bashku me ofertën ekonomike për devijime shumë të vogla, vlerësojmë se i plotëson kriteret e kërkesave të kualifikimit, ku KVO<sup>ja</sup> gjatë shqyrtimit e vlerësimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit “*oferta më e ulët*” dhe në procesin e vlerësimit duhej të kishte qenë më fleksibël për të kualifikuar këtë ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme, sepse me dokumentat e paraqitura nuk ka sjell asnjë deformim të ofertës në përmbushjen e detyrimeve, veprim në mospërputhje me nenin 53 “*Shqyrtimi ofertave*”, pika (4) dhe neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, me pasojë përdorimin e fondit publik pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet për **vlerën 35,480 lekë pa tvsh** (si diferencë ndërmjet ofertës fituese e ofertës së skualifikuar me vlerë më të ulët në konkurrim). (Trajtuar më hollësisht në pika 4 programi, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit)

**4.3.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion objekte shkollore Njësitë Administrative faza II*” e zhvilluar në datë 02.11.2018, me fondi limit 3.058.717 lekë pa tvsh. Në këtë procedurë kanë marr pjesë 8 OE, ndërsa KVO ka vlerësuar, klasifikuar, kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE “A■”shpk e klasifikuar në radhitje (*e dyta*) me vlerë 2.059.000 lekë pa tvsh, ndërsa është skualifikuar oferta konkurrese OE “N■”shpk e klasifikuar në radhitje (*e para*) me vlerë 1.999.657 leke pa tvsh më e ulët se oferta e shpallur fituese me diferencë shuma 59.343lekë pa tvsh, ndërsa nga auditimi rezulton se; KVO në lidhje me mosvlerësimin e ofertës me vlerë më të ulët është gabuar në vlerësimin e dhënë, sepse kjo ofertë e pa vlerësuar me dokumentat e dorëzuara së bashku me ofertën ekonomike për devijime shumë të vogla, vlerësojmë se i plotëson kriteret e kërkesave të kualifikimit, ku KVO<sup>ja</sup> gjatë shqyrtimit e vlerësimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit “*oferta më e ulët*” dhe në procesin e vlerësimit duhej të kishte qenë më fleksibël për të kualifikuar këtë ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme, sepse me dokumentat e paraqitura nuk ka sjell asnjë deformim të ofertës në përmbushjen e detyrimeve, veprim në mospërputhje me nenin 53 “*Shqyrtimi ofertave*”, pika (4) dhe neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, me pasojë përdorimin e fondit publik pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet për **vlerën 59.343 lekë pa tvsh** (si diferencë ndërmjet ofertës fituese e ofertës së skualifikuar me vlerë më të ulët në konkurrim). (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit)

**4.4.Gjetjenga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt; “*Riparim vepra ujore, portobarazhe në fushën e Maliqit*” e zhvilluar në datë 01.04.2019, me fondi limit 4.664.326 lekë pa tvsh. Në këtë procedurë kanë marr pjesë 4 OE, ndërsa KVO ka vlerësuar, klasifikuar, kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE “A■”shpk e klasifikuar në radhitje (*e dyta*) me vlerë 3.205.188 lekë pa tvsh, ndërsa është skualifikuar oferta konkurrese OE “N■”shpk e klasifikuar në radhitje (*e para*) me vlerë 1.732.518 leke pa tvsh më e ulët se oferta e shpallur fituese me diferencë shuma 273.389 lekë pa tvsh, ndërsa nga auditimi rezulton se; KVO në lidhje me mosvlerësimin e ofertës me vlerë më të ulët është gabuar në vlerësimin e dhënë, sepse kjo ofertë e pa vlerësuar me dokumentat e dorëzuara së bashku me ofertën ekonomike për devijime shumë të vogla, vlerësojmë se i plotëson kriteret e kërkesave të kualifikimit, ku KVO<sup>ja</sup> gjatë shqyrtimit e vlerësimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit “*oferta më e ulët*” dhe në procesin e vlerësimit duhej të kishte qenë më fleksibël për të kualifikuar këtë ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme, sepse me dokumentat e paraqitura nuk ka sjell asnjë deformim të ofertës në përmbushjen e detyrimeve, veprim në mospërputhje me nenin 53 “*Shqyrtimi ofertave*”, pika (4) dhe neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, me

pasojë përdorimi fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet për vlerën 273.389 lekë pa tvsh (si diferencë ndërmjet ofertës fituese e ofertës së skualifikuar me vlerë më të ulët në konkurrencë). (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**4.5.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale ndërtimi” e zhvilluar në datë 20.02.2019, me fond limit 3.710.560 lekë pa tvsh. Në këtë procedurë kanë marr pjesë 12 OE, ndërsa KVO ka vlerësuar, klasifikuar, kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE “A”shpk e klasifikuar në radhitje (e treta) me vlerë 3.256.250lekë pa tvsh, ndërsa është skualifikuar oferta konkurrese OE “D”shpk e klasifikuar në radhitje (e dyta) me vlerë 3.171.564 leke pa tvsh më e ulët se oferta e shpallur fituese me diferencë shuma 257.798 lekë pa tvsh, ndërsa nga auditimi rezulton se; KVO në lidhje me mosvlerësimin e ofertës me vlerë më të ulët është gabuar në vlerësimin e dhënë, sepse kjo ofertë e pa vlerësuar me dokumentat e dorëzuara së bashku me ofertën ekonomike për devijime shumë të vogla, vlerësojmë se i plotëson kriteret e kërkesave të kualifikimit, ku KVO<sup>ja</sup> gjatë shqyrtimit e vlerësimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit “*oferta më e ulët*” dhe në procesin e vlerësimit duhej të kishte qenë më fleksibël për të kualifikuar këtë ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme, sepse me dokumentat e paraqitura nuk ka sjell asnjë deformim të ofertës në përmbushjen e detyrimeve, veprim në mospërputhje me nenin 53 “Shqyrtimi ofertave”, pika (4) dhe neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, me pasojë përdorimi fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet për vlerën 257.798 lekë pa tvsh (si diferencë ndërmjet ofertës fituese e ofertës së skualifikuar me vlerë më të ulët në konkurrencë). (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**4.6.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale ngrohje; Loit (I) druzjarri; Loti (II) pelet” e zhvilluar në datë 08.02.2019, me fond limit 1.051.091 lekë pa tvsh. Në këtë procedurë kanë marr pjesë 4 OE, ndërsa KVO ka vlerësuar, klasifikuar, kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën ekonomike e paraqitur në konkurim nga OE “S”shpk e klasifikuar në radhitje (e dyta) me vlerë 1.031.553 lekë pa tvsh, ndërsa është skualifikuar oferta konkurrese OE “B”shpk e klasifikuar në radhitje (e para) me vlerë 1.015.924 leke pa tvsh më e ulët se oferta e shpallur fituese me diferencë shuma 15.629 lekë pa tvsh, ndërsa nga auditimi rezulton se; KVO në lidhje me mosvlerësimin e ofertës me vlerë më të ulët është gabuar në vlerësimin e dhënë, sepse kjo ofertë e pa vlerësuar me dokumentat e dorëzuara së bashku me ofertën ekonomike për devijime shumë të vogla, vlerësojmë se i plotëson kriteret e kërkesave të kualifikimit, ku KVO<sup>ja</sup> gjatë shqyrtimit e vlerësimit të ofertave duhej të kishte qenë më i saktë në zbatimin e kërkesave të parashikuara nga LP, duke pasur në konsideratë kriterin bazë të vlerësimit “*oferta më e ulët*” dhe në procesin e vlerësimit duhej të kishte qenë më fleksibël për të kualifikuar këtë ofertë ekonomike me vlerë më të favorshme, sepse me dokumentat e paraqitura nuk ka sjell asnjë deformim të ofertës në përmbushjen e detyrimeve, veprim në mospërputhje me nenin 53 “Shqyrtimi ofertave”, pika (4) dhe neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, me pasojë përdorimi fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet për vlerën 15.629 lekë pa tvsh (si diferencë ndërmjet ofertës fituese e ofertës së skualifikuar me vlerë më të ulët në konkurrencë). (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**4.7-Rekomandimi:** Titullari Autoritetit Kontraktor, njësia publike vendore (bashkia Maliq), të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësit për kualifikimin dhe mos kualifikimin e OE konkurrese, ndërkohë KVO me qëndrim strikt në vlerësimin e ofertave konkurrese me vlerë më të ulët se oferta e shpallur fituese, për devijime të vogla në plotësimin e kriterëve të kërkesave kualifikuese, e cila sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik, pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën prej 17.806.465 lekë pa tvsh. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi kontraktori për shkak të mangësive nuk jep siguri për kryerjen me sukses e cilësi të kushteve të kontratës.

*Menjëherë.*

**5.Gjetje nga auditimi:** Në 3(tre) procedura prokurimi u konstatua se, Komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të mjeteve të transportit (*2 mjete zjarrfikëse dhe 1 mjet autoveturë*), nuk ka krahasuar specifikimet teknike të automjeteve të ofertuar në konkurim me specifikimet e mjetit të dorëzuar sipas dokumentave të mjetit të cilat janë edhe element për skualifikim me kriteret e kërkesave kualifikuese me deklaram të specifikimeve teknike në (*shtojcat përkatëse*), çka ka sjell pasojë likuidimin e vlerës së kontratës dhe shtesën e “*aktive afatgjata materiale*”, për mjet që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në specifikimet teknike në DST, e cila sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik *pa ekonomicitet, efincencë dhe efektivitet në vlerën 7.702.000 lekë* të detajuara për secilën procedurë sa më poshtë: (*Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit*).

**5.1.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje mjeti zjarrfikëse (II)*” e zhvilluar në datë 22.11.2018, me fond limit *3,200,000 lekë pa tvsh*. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjetit zjarrfikëse janë përshkruar 21 specifikime teknike të mjetit zjarrfikëse të miratuara në DST Shtojca (11), ndërsa nuk janë të krahasuara me specifikimet teknike të mjetit që OE ka paraqitur në konkurim bashkëlidhur me ofertën ekonomike (*me deklaram*). Nuk ka evidentuar në se, mjeti zjarrfikëse i marr në dorëzim është apo jo i shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimit në DST “*Kapaciteti teknik*” nënpika (4). Në përfundim mjeti zjarrfikës është marr në dorëzim pa plotësuar kërkesat kualifikues si me deklaram të parashikuara në DST (*shtojca 11*), çka ka sjell likuidim të vlerës së kontratës me shtesë në “*aktive afatgjata materiale*” jashtë kushteve e specifikimeve teknike, njëkohësishtë edhe pa plotësuar kriteret e kërkesave të kualifikimit, sepse specifikimet teknike janë element skualifikimi (*me deklaram*) në vlerësimi ofertës ekonomike, ndërsa likuidimi kontratës është në mospërputhje me nenin (8) “*Kontrolli i cilësisë së mallit*”. Në këto kushte marrja në dorëzim e mjetit zjarrfikëse pa plotësuar kriteret e specifikimeve teknike e cila sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik *pa ekonomicitet, efincencë dhe efektivitet në vlerë 3.190.000 lekë*. (*Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit*).

**5.2.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje mjet zjarrfikëse (I)*” e zhvilluar në datë 18.06.2018, me fond limit *3,333,300 lekë pa tvsh*. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjetit zjarrfikëse janë përshkruar 23 specifikime teknike të mjetit zjarrfikëse të miratuara në DST, Shtojca (9), ndërsa nuk janë të krahasuara me specifikimet teknike të mjetit që OE ka paraqitur në konkurim bashkëlidhur me ofertën ekonomike (*me deklaram*). Nuk ka evidentuar në se, mjeti zjarrfikëse i marr në dorëzim është apo jo i shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimit në DST “*Kapaciteti teknik*” nënpika (4). Në përfundim mjeti zjarrfikës është marr në dorëzim pa plotësuar kërkesat kualifikues si me deklaram të parashikuara në DST, pika (3) në (*shtojca 9*), çka ka sjell likuidimin e vlerës së kontratës me shtesë në “*aktive afatgjata materiale*” jashtë kushteve e specifikimeve teknike, njëkohësishtë edhe pa plotësuar kriteret e kërkesave të kualifikimit, sepse specifikimet teknike janë element skualifikimi (*me deklaram*) në vlerësimi ofertës ekonomike, ndërsa likuidimi kontratës është në mospërputhje me kushtet e parashikuara nga neni (8) “*Kontrolli i cilësisë së mallit*”. Në këto kushte marrja në dorëzim e mjetit zjarrfikëse pa plotësuar kriteret e specifikimeve teknike, e cila sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik *pa ekonomicitet, efincencë dhe efektivitet në vlerë 3.312.000 lekë*. (*Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit*).

**5.3.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje mjet transporti për nevojat e Bashkisë*” e zhvilluar në datë 18.06.2018, me fond limit *1,250,000 lekë pa tvsh*. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjetit zjarrfikëse janë përshkruar 23 specifikime teknike të mjetit zjarrfikëse të miratuara në DST, Shtojca (9), ndërsa nuk janë të krahasuara me specifikimet teknike të mjetit që OE ka paraqitur në konkurim bashkëlidhur me ofertën ekonomike (*me deklaram*). Nuk ka evidentuar në se, mjeti zjarrfikëse i marr në dorëzim është apo jo i shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimit në DST “*Kapaciteti teknik*” nënpika (4). Në përfundim mjeti zjarrfikës është marr në dorëzim pa plotësuar kërkesat kualifikues si me deklaram të parashikuara në DST, pikat (6) dhe (14) në (*shtojca 9*), çka ka sjell likuidimin



e vlerës së kontratës me shtesë në “aktive afatgjata materiale” jashtë kushteve e specifikimeve teknike, njëkohësisht edhe pa plotësuar kriteret e kërkesave të kualifikimit, sepse specifikimet teknike janë element skualifikimi (*me deklaram*) në vlerësimi ofertës ekonomike, ndërsa likujdimi kontratës është në mospërputhje me kushtet e parashikuara nga neni (7) “Detyrimet e furnizuesit”, pika (1) “...furnizuesi është i detyruar të sigurojë sjelljen e mjtit si kërkohet nga AK dhe kushtet e specifikuara në kontratë”. Në këto kushte marrja në dorëzim e mjetit të transportit pa plotësuar kriteret e specifikimeve teknike, ka sjell pasojë përdorimin e fondit publik *pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerë 1.200.000 lekë.* (Trajtuar më hollësisht në pika 4 e programit, faqe 61-96 të Raportit të Auditimit).

**5.4-Rekomandimi:** Titullari i Autoriteti Kontraktor, njësia publike vendore (*bashkia Maliq*), të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertës e vetme në konkurim e cila nuk plotëson kriteret e kërkesave të kualifikimit në DST, njëkohësisht edhe marrja në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim i mjeteve të transportit të cilat nuk plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në DST, e cila sjellë efekt negativ financiar me impakt në përdorimin e fondit publik, *pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën totale 7.702.000 lekë pa tvsh.* Të konsiderojë faktin se kualifikimi i ofertës ekonomike r cila nuk plotësonë kriteret e kualifikimit në DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, është edhe rrishtë real për njësinë vendore, pasi këta OE për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me cilësi të kontratës.

*Menjëherë.*

#### **D-MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave konstatohet se, në fund të periudhës janë gjithsej debitorë **88** subjekte në vlerë **2,801,492 lekë** dhe **11991** familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerë **68,588,004 lekë.**

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimin të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në faqen 20-29 të Raportit të Auditimit).

**1.1-Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Maliq të marr masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për **88** subjekte në vlerë **2,801,492 lekë** dhe **11991** familje në vlerë gjithsej **68,588,004 lekë.**(sipas pasqyrave aneks nr 17,18 dhe 19), bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d-Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 “Mospagimi taksave

dhe tatimeve”.

*Menjëherë.*

**2.Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkisë Maliq, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **134** persona me vlerë **7,063,019 lekë**, për periudhën 01.01.2016–31.12.2019, të cilat përbejnë **të ardhura të munguara** për Buxheti Bashkisë Maliq sipas pasqyrës Aneks 20. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 20-29 të Raportit të Auditimit).*

**2.1-Rekomandimi:** Bashkia Maliq, nëpërmjet Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marr masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerë **7,063,019 lekë**.

*Menjëherë.*

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi praktikave të pajisjes me Autorizim/Licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë u konstatua se nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Maliq për vitet 2018-2019, ndaj subjekteve “G” shpk me NIPT K66801001T, “D” shpk me NIPT K92312006C dhe “S” shpk, me NIPT K33916003M, nuk është aplikuar saktë tarifa vendore për pajisjen e tyre, me Autorizim/Licenca në kundërshtim me VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kap II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, e cila ka sjell të **ardhura të munguara** për buxheti Bashkisë Maliq në vlerë **2.400,000 lekë**. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 20-29 të Raportit të Auditimit).*

**3.1-Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Maliq të marrin masa për arkëtimin e vlerës **2.400.000 lekë**, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, si më poshtë:

- “G” shpk për vlerën prej **800.000 lekë**,
- “D” shpk, për vlerën prej **800.000 lekë**,
- “S” shpk, për vlerën prej **800.000 lekë**.

*Menjëherë.*

**4.Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Maliq, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e të detyrimeve nga subjekti “A” shpk, për kontratën nr. 4834 Rep, nr. 3269 Kol, datë 26.07.2017 për shfrytëzim të fondit pyjorë të një sipërfaqe prej 0.15 ha për vendosjen e tubacioneve në gjatësinë 1.275 km, në vlerën 224,400 lekë, detyrime të vitit 2019 dhe subjekti “Th” shpk nuk ka paguar detyrimet e vitit 2019, për kontratën nr. 1706 Rep, nr. 2052 Kol, datë 01.10.2010 për shfrytëzim të tregut të fruta-perimeve në Nj/Administrative Pirg me sipërfaqe ndërtese prej 300 m<sup>2</sup>, në vlerën 781,899 lekë, gjithsej në vlerën **1,006,299 lekë** me pasojë **të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë Maliq, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin”, nenin 12, germa “g” dhe kushteve të kontratës. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 20-29 të Raportit të Auditimit).*

**4.1-Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Maliq të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktore në vlerën **1,006,299 lekë**, për subjektet si më poshtë:

- “A” shpk për vlerën **224,400 lekë**,
- “Th” shpk për vlerën **781,899 lekë**.

*Menjëherë.*

## **E. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim Ujësjellës Bregas, Strelcë” Bashkia Maliq me vlerë 20,532,012 lekë me TVSH, fituar

nga OE "A" SHPK rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve, në kapitujt: Ujësjetësi fshatit Bregas, Rehabilitim depo uji dhe Rehabilitim stacioni pompimit, të kryera në objekt në shumën 442,562 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr.4356 Prot, datë 17.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Maliq dhe OE "A" SHPK. (Trajtuar më hollësisht në faqet 96-104 të Raportit të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Maliq, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE "A" SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që shuma 442,562 lekë pa TVSH të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 10.10.2020 për të garantuar cilësinë dhe funksionalitetin e ujësjetësit. Realizimi punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Maliq, Mbikëqyrësi punimeve dhe Kolaudatori i punimeve të objektit, brenda periudhës së garancisë. Në rast të kundërt moskryerja e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe specifikimeve teknike, do konsiderohet dëm ekonomik dhe Bashkia Maliq duhet të marrë masa për arkëtimin e vlerës 442,562 lekë pa TVSH.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Sistemim-asfaltim Maliq+Njësitë Administrative" Bashkia Maliq me vlerë 26,023,380 lekë me TVSH fituar nga OE "V" SHPK rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt, konkretisht: shtresë me pllaka vetështrënguese betoni t=6 cm; shtresë stabilizanti t=10 cm + spërkatje në shumën 418,721 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2217 Prot, datë 06.06.2018 lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Maliq dhe OE "V" SHPK. (Trajtuar më hollësisht në faqet 96-104 të Raportit të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Maliq të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 418,721 lekë pa TVSH nga OE "Vashtëmia" SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2217 prot, datë 06.06.2018 me objekt "Sistemim-asfaltim Maliq + Njësitë Administrative", Bashkia Maliq vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Sistemim – asfaltim i rrugës në fshatin Plasë" Bashkia Maliq me vlerë 8,028,300 lekë me TVSH fituar nga OE "V" SHPK rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt, konkretisht: shtresë me pllaka vetështrënguese betoni t=6 cm, në shumën 233,247 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr.2790 Prot, datë 21.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Maliq dhe OE "V" SHPK. (Trajtuar më hollësisht në faqet 96-104 të Raportit të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Maliq të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 233,247 lekë pa TVSH nga OE "V" SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2790 prot, datë 21.06.2019 me objekt "Sistemim-asfaltim i rrugës në fshatin Plasë", Bashkia Maliq, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumit të situacionuar.

*Menjëherë.*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion objekte shkollore + terrene" Bashkia Maliq me vlerë 11,275,512 lekë me TVSH, fituar nga BOE "V" SHPK & "A" SHPK rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt konkretisht: punime shtresash dhe punime elektrike në shumën 469,950 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2306 Prot, datë 03.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Maliq dhe BOE "V" SHPK & "A" SHPK. (Trajtuar më hollësisht në faqet 96-104 të Raportit të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Maliq që ti kërkojë sipërmarrësit të punimeve BOE “V” SHPK & “A” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që:

-Shuma prej **203,700 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 10.10.2020 për të garantuar cilësinë dhe funksionalitetin e shkollës 9/vjeçare Libonik. Realizimi punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Maliq, Mbikëqyrësi punimeve dhe Kolaudatori punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

-Arkëtimin e shumës prej **266,250 lekë pa TVSH** nga BOE “V” SHPK & “A” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2306 prot, datë 03.05.2019 me objekt “Rikonstruksion objekte shkollë+terrene” Bashkia Maliq, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumit të situacionuar.

*Menjëherë.*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim porta dhe ura në fushën e Maliqit” Bashkia Maliq me vlerë 10,028,256 lekë me TVSH fituar nga OE “N” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në shumën **200,805 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2198 Prot, datë 05.06.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Maliq dhe OE “N” SHPK. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 96-104 të Raportit të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Maliq të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **200,805 lekë pa TVSH** nga OE “N” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.2198 prot, datë 05.06.2018 me objekt “Ndërtim porta dhe ura në fushën e Maliqit” bashkia Maliq, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumit të situacionuar dhe specifikimeve teknike.

*Menjëherë.*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim KUZ në njësitë administrative viti 2018” Bashkia Maliq me vlerë 10,996,680 lekë me TVSH, fituar nga OE “S” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në shumën **285,430 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.1192 Prot, datë 13.03.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Maliq dhe OE “S” SHPK. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 96-104 të Raportit të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Maliq, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **285,430 lekë pa TVSH** nga OE “S” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1192 prot, datë 13.03.2019 me objekt “Ndërtim KUZ në njësitë administrative viti 2018” bashkia Maliq, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumit të situacionuar e specifikimeve teknike.

*Menjëherë.*

## **F. MASA DISIPLINORE:**

### **F/1 Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil:**

Mbështetur në nenin 15, shkronja (c), të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH<sup>se</sup>, për periudhën (01.01.2018 deri 31.12.2019), të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për **25 (punonjësit)** si më poshtë:

**-Për 13 anëtarë të Komisionit për marrje në dorëzim të automjeteve, si më poshtë vijon:**

- 1-z.A.M me detyrë Mbikqyrës mjatesh në Drejtoria Mekanike.
- 2-z.ES me detyrë Përgjegjës Sektori Shërbimeve B.Qendër.
- 3-z.SH me detyrë Përgjegjës Sektori Mekanik.
- 4-z.FT me detyrë Drejtor Sportit e Kultures.
- 5-z.FS me detyrë Teknik i Rjetit kompjuterik zyra IT dhe Promovimit.
- 6-z.HL me detyrë Magazinjer.
- 7-z.AE me detyrë Projektues Urbanist sektori Planifikimi Territori e Lejeve.
- 8-z.SK me detyrë Përgjegjës Sektori Hartimit dhe Implementimit të Projekteve.
- 9-znj.JL me detyrë Nënkyetare e bashkisë.
- 10-z.RA me detyrë Elektriçist Sektori Shërbimit Publik Libonik.
- 11-znj.FD me detyrë Përgjegjëse sektori menaxhimit të aktiveve.
- 12-znj.NL me detyrë Specialiste finance.
- 13-z.SC me detyrë Përgjegjës mjatesh.

**a-**Për shkeljet e konstatuara në realizimin e kontratës nr.1896, datë 15.05.2018 e lidhur me objekt *“Blerje mjet transporti për nevojat e Bashkisë”*, pasi specifikimet teknike të automjetit që është ofertuar në konkurim, nuk përputhen me specifikimet e mjetit të dorëzuar sipas librezës së mjetit, të cilat komisioni i marrjes në dorëzim nuk i ka krahasuar specifikimet teknike si element për skualifikim me kriteret e kërkesave kualifikuese, sepse nuk i ka evidentuar këto ndryshime. Në këto kushte marrja e mjetit në dorëzim, si dhe likuidimi i kontratës pa plotësuar kërkesat e parashikuara në specifikime teknike të DST, **shtojca (9)** *“Specifikime teknike”*, pikat (6) e (14), veprime në mospërputhje me kushtet e kontratës neni (7) *“Detyrimet e furnizuesit”*, pika (1) *“...furnizuesi është i detyruar të sigurojë sjelljen e mjetit si kërkohet nga AK dhe kushtet e specifikuar në kontratë”*..

**b-**Për shkeljet e konstatuara në realizimin e kontratës nr.2895, datë 26.07.2018 e lidhur me objekt *“Blerje mjeti zjarrfikëse I”*, pasi komisioni në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjetit zjarrfikëse ka përshkruar 23 specifikime teknike të pasqyruar Shtojca (9), ndërsa nuk ka krahasuar këto specifikime teknike me specifikimet teknike që OE ka paraqitur në konkurim bashkëlidhur me ofertën ekonomike. Komisioni nuk ka evidentuar në se janë plotësuar specifikimet që i përkasin dokumentacionin shoqëruar të ofertës në cilësinë e kriterit kualifikues.

**c-**Për shkeljet e konstatuara në realizimin e kontratës nr.5076, datë 24.12.2018 e lidhur me objekt *“Blerje mjeti zjarrfikëse II”*, pasi komisioni në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjetit zjarrfikëse ka përshkruar 21 specifikime teknike të mjetit zjarrfikëse, ndërsa nuk ka krahasuar specifikimet teknike të miratuara në DST në Shtojca (11) me specifikimet teknike të mjetit që OE ka paraqitur në konkurim bashkëlidhur me ofertën ekonomike (*me deklaram*). Për mjetin zjarrfikëse i marr në dorëzim disa specifikime teknike të pasqyruara të krahasuara me specifikimet në DST.

**-Për 5 anëtarë Komisioni Hartimit të Specifikime Teknike pjesë e DST, si më poshtë vijon:**

- 1-z.KJ, me detyrë Jurist për Prokurimet.
- 2-znj.VB, me detyrë Specialiste për Prokurimet.
- 3-znj.OI, me detyrë Specialist për prokurimet.
- 4-z.SK, me detyrë Përgjegjës në Sektori Hartimit dhe Implementimit të Projekteve.
- 5-znj.JG, me detyrë Drejtor të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore.

-Për shkeljet e konstatuara në 4 (katër) procedura prokurimi të realizuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Maliq më konkretisht;

- *“Riparim vepra ujore, portobarazhe në fushën e Maliqit”*.
- *“Rikonstrukcion objekte shkollore Njësitë Administrative faza II”*.
- *“Ndërtim Ujësjellës Bregas, Strelcë”*.
- *“Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit”*.

-Në lidhje me mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik,

konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2).

**-Për 6 anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si më poshtë vijon:**

**1-znj.MZ** me detyrë Specialist në Sektori Hartimit e Implementimi Projekteve.

**2-znj.MS** me detyrë Përgjegjës Sektori Finances, Kontabilitet, Buxhetit.

**3-znj.FR** me detyrë Specialiste sektori IT.

**4-znj.FD** me detyrë Përgjegjëse sektori menaxhimit të aktiveve.

**5-znj.SM** me detyrë Specialiste për Prokurimiet/Kontratitat.

**6-z.KM** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Mekanike.

-Për shkeljet e konstatuara në 6 (gjashtë) procedura prokurimi të realizuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Maliq më konkretishtë;

-“Blerje materiale ngrohje; Loit (I) druzjarri; Loti (II) pelet”.

-“Blerje materiale ndërtimi”.

-“Riparim vepra ujore, portobarazhe në fushën e Maliqit”

-“Rikonstruksion objekte shkollore Njësitë Administrative faza II”.

-“Ndërtim Ujësjellës Bregas, Strelcë”.

-“Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit”

Në lidhje me vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “Anulimi një procedure prokurimi”, pika (1), germa (ç); neni (46) “Kualifikimi i ofertuesve”, pika (1); neni (53) “Shqyrtimi ofertave”, pika (3) dhe (5), gërma (a); (c); neni (55) “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe neni (66) “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika (3); neni (67) “Klasifikimi ofertave; neni (68) “Raporti përmbledhës”; Kreu (VIII) “Kushte të përgjithshme për zbatim”; neni (73) “Mungesa e konkurrencës”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**7-znj.AS** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave.

-Për punë të pamjaftueshme për arkëtimin e debitorëve për 88 subjekte në vlerën 2,801,49 lekë, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

-Mosndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktore në vlerën 1,006,299 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin”, nenin 12, germa “g” dhe kushteve të kontratës.

-Nuk është aplikuar saktë tarifa vendore për pajisen, me Autorizim/Licenca për 3 subjekte në vlerë 2.400,000 lekë e cila ka sjell të ardhura të munguara për buxheti Bashkisë Maliq, në kundërshtim me VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kap II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.

**G-Shënimi i Kryetarit:** Vërejtjet e Drejtorit të Departamentit, Drejtorit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe vërejtjet e Drejtorit të Përgjithshëm, duhet të bëhen pjesë e diskutimeve dhe analizave departamentale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së gjetjeve, rekomandimeve dhe raportimit në të ardhmen.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore.

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**